



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Department of Freelance Professions
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.09/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.50/18, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, fadilete Hoxha-Blakqori, pala ankuese dhe Përmbaruesi Privat, me datë 14.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-09/2023 i datës 20.02.2023 dhe ankesa e palës ankuese e datës 27.01.2023 **si të Pa Bazuara**.

II. Përmbaruesi Privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore, nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P.nr.50/18.

A r s y e t i m

Me datën 27.01.2023 pala ankuese ka parashtruar ankesë ndaj përmbaruesit privat me pretendimin se në mes palëve në lëndën P.nr.50/2018, para përmbaruesit palët kanë arritur marrëveshje për pagesë të obligimit me marrëveshje me tre këste. Kësti i parë është paguar por tjerat jo.

Me datën 18.02.2021, ka ndërruar jetë pronarja e debitorit, për këtë e ka njoftuar përmbaruesin privat dhe ka kërkuar që për këtë shkak të pushohet kjo procedurë.

pa vendosur ne gjykatën komerciale, ne shkallen e parë. Meqenëse nuk kisha alternativa tjera ju kam drejtu Komisionit disiplinor për të ndërmarr masa disiplinore ndaj përmbaruesit privat konform dispozitave ligjore.

Përmbaruesi ka deklaruar se është e vërtetë se ka vdekur vajza e () këtui prezent e quajtur () por shtoj se është fjala për Shoqëri Aksionare që e posedon pasurinë e vet aktive dhe pasive dhe nuk është fjala për çështjen e pasurisë personale për te cilën mundet te përgjigjet pretenduesi () ngase ne kontaktet tona te rregullta kam kërkuar që ky person duhet te këtë autorizim legjitim për te ndërmarr veprime te caktuar për shoqërinë aksionare ne fjalë. Ne kemi pas disa kontakte dhe i kam tregu qe nuk ke legjitimitet se nuk ke autorizim. Për me tepër mbetem ne terësi pranë përgjigjes se parashtruar me shkrim sepse deri ne këtë moment palës ankuese i mungon legjitimiteti për sa i përket çështjes se përfaqësimit te biznesit, sepse çështjet tjera nuk janë kontestuese dhe unë si përmbarues privat nuk mund te ndërmarrë veprime pa qenë i regjistruar () si përfaqësues ose pronar i Biznesit () sepse nuk jam organ ku mund ti ndërroj emërtimet e biznesit.

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërën nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së.

Këtë konstatim komisioni e bazon në faktin se përmbaruesi ka vepruar duke u bazuar ne shkresat e lëndës ku shihet që edhe vetë pala debitore ka arritur marrëveshje për pagesë me këste të obligimit, por nuk i është përmbajtur dhe pas kësaj janë ndërmarrë veprim përmbarimore, ndërsa sa i përket përfaqësimit të debitorit, bazuar në shkresat e rastit, pala ankuese nuk figuron që është përfaqësues ose pronar i biznesit që në këtë rast është debitor dhe të pjesë nuk e ka trajtuar.

Komisioni ka trajtuar të gjitha provat dhe deklaratimet e palëve dhe bazuar në ato vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr.09/2023 datë 14.04.2023

Kryesuese e Komisionit Disiplinor
Manushë Karaqi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqura të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.